



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 679/2023

13/07/2023

URDHËR

Nr. 58, datë 13/07/2023

MBI

“MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR. 10, DATË 10.07.2023 “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim, i ndryshuar me VKM Nr. 46, datë 27.01.2021 ‘Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 436, datë 3.6.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, Urdhëri i Përbashkët Nr. 10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024”, Udhëzimit Nr. 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VSA Nr. 04, datë 02.02.2022; VSA Nr. 05, datë 02.02.2022, VSA Nr. 06, datë 02.02.2022, VSA Nr. 10, datë 09.02.2023; VSA Nr. 11, datë 09.02.2023, VSA Nr. 12, datë 09.02.2023,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2023-2024, me përbërje si më poshtë:
 - Prof. Arian Paço
 - Prof. Dr. Erald Bakalli
 - Znj. Suela Kromidha

2. Konkursët e pranimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor, të ofruara nga Fakultetet e UART do të zhvillohen **nga data 21 Gusht 2023 deri në datën 24 Gusht 2023**.
3. Administruesi i UART, për sistemin e Portalit U – Albania (Përgjegjësi i Sektorit të IT) të marrë masa që **brenda datës 06 Gusht 2023**, të shkarkojë nga Portali U – Albania listën e kandidatëve që konkurojnë në programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor, të ofruara nga UART dhe tua përcjellë Sekretarive mësimore për secilin Fakultet si dhe ti publikojë në faqen zyrtare elektronike të UART, sipas përcaktimeve ligjore.
4. Sekretaritetë mësimore të Fakulteteve të UART, **brenda datës 06 Gusht 2023**, ti afishojnë në mjediset e Fakulteteve listën e kandidatëve për konkursët e pranimit 2023-2024.
5. Regjistrimi i konkurrentëve për në konkursët e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor, në të gjitha Fakultetet e UART, për të gjitha programet e studimeve të ofruara, bëhet pranë Sekretarive mësimore, dhe **fillon në datën 14 Gusht 2023 nga ora 08:00 deri në orën 16:00**. Konkurrentët të regjistrohen deri në ditën dhe orarin e përcaktuar nga secili Fakultet për fillimin e konkurseve të pranimit.
6. Dokumentacioni për tu regjistruar në konkursët e pranimit është:
 - Mandati i pagesës së tarifës së konkurimit
 - Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës
7. Regjistrimi pranë Sekretarive mësimore të Fakulteteve të UART, bëhet nga vetë konkurenti ose nga një person i autorizuar prej tij/saj, me prokurë të posaçme.
8. Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkursët e pranimit të ciklit të parë, Bachelor, vetëm kandidatët sipas listës së shkarkuar nga portali U-Albania.
9. I gjithë kalendari i procedurave do të bëhet në zbatim të Urdhërit të përbashkët Nr. 10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024”.
10. Të afishohen në mjediset e secilit Fakultet të UART, Urdhërat/Vendimet mbi masat e marra për konkursët e pranimit, Rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme për këtë proces.
11. Strukturat përgjegjëse të secilit Fakultet të marrin masat e nevojshme për zhvillimin e konkurseve të pranimit si dhe ndjekjen me përgjegjësi të afateve të përcaktuara sipas etapave të zhvillimit të konkurseve dhe procedurave të regjistrimit të kandidatëve/studentëve deri në përcjelljen e tyre për numër matrikullimi në zbatim të kalendarit të Urdhërit të Përbashkët Nr. 10, datë 10.07.2023
12. Sektori i Shërbimeve si dhe Fakultetet në UART të marrin masat e nevojshme për përgatitjen e ambienteve në të cilat do të zhvillohen konkursët e pranimit për të gjitha programet e studimit.
13. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri anëtarët e grupit të monitorimit; Administratori i UART; Dekanët e Fakulteteve të UART; Përgjegjësit e Njësive bazë të Fakulteteve të UART; Sekretaritetë mësimore të Fakulteteve të UART; Drejtoria Ekonomike e UART; Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Statistikave, Juridike dhe Protokoll Arkivës; Drejtoria e Bibliotekës së UART; Sektori Mësimor dhe i Kurikulës, Informimit dhe Këshillimit të Studentëve, Alumni; Sektori i Teknologjisë së

Informacionit; Sektori i Statistikava; Sektori i Shërbimeve dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.

14. Të njoftohet për marjen e masave të veçanta për administrimin dhe ruajtjen e ambienteve të UART, për periudhën e konkurseve, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike ILLYRIAN GUARD.
15. Ky Urdhër të shpallet në faqen zyrtare të WEB-it, të Universitetit të Arteve

Ky Urdhër hun në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot ÇAUSIII

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Prof. Arian PACO

**ZËVENDËS REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**

